



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 61 prot.

Himarë, më 31.01.2024

**PROCESVERBAL I KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË, ZBARDHUR NGA  
ORGJINALI, MBI MBLEDHJEN E RADHËS TË MUAJT JANAR, DATË 31.01.2024**

**1. Në mbledhje marrin pjesë këshilltarët:**

Elisabeta Lamaj, Dhimitër Kapaj, Thodhori Foto, Mirka Gjiçali, Milto Nika, Aleks Llazari, Silva Burbo, Fuat Mati, Timoleo Gërdhuqi, Lenica Kocani, Nertila Husi, Artan Bala, Thëllëza Kokaveshi, Qirjako Mërkuri, Artionil Shirokaj.

**2. Mungojnë:** Miltiadh Prifti, Nikolinë Laska ( me arsye) , Gjergj Iliadhi, Afrovita Dhimojani, Maks Vlasi, Loreta Isufi.

**Në mbledhje marrin pjesë të ftuar:**

Drejtoritë e drejtorive, administratorët e njësive të Bashkisë Himarë, kryetarët e fshatrave, banorë.

Sigurohet mbi 50% pjesëmarrja e këshilltarëve.

Mbledhjen e hap Kryetari i Këshillit Z. Dhimitër Kapaj.

**3. Miratimi i rendit të ditës.**

**Kryetari Këshillit:** - Jeni dakort me rendin e ditës? **PO** -Këshilltarët.

**Miratohet rendi ditës.**

**Pika e dytë e rendit të ditës**

Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për miratimin e planit të punës, planit të sezonit turistik për vitin 2024.

**Këshilltari Timoleo Gërdhuqi** : - duhet të ngrihet një komision për rishikimin e buxhetit.

**Kryetari këshillit** :- kemi patur investime në njësinë Horë – Vranisht dhe nuk janë investuar sepse ka munguar projekti, nëse vazhdohet në këtë mënyrë ne si këshill nuk miratojmë asnjë vendim, ndaj le të ngrihet një komision për verifikimin e të gjithave investimeve që janë miratuar.

**Drejtori Sokrat Kreku** jep informacion rreth sezonit turistik për vitin 2024.

**Kryetari i këshillit :** Kërkoj një informacion ,pse dy punonjës të pastrimit në njësinë Horë – Vranisht paguhen me 25 mijë lekë të reja ? A ka urdhër nga Bashkia për monitorim për punëtorët e pastrimit?

**Këshilltari Timoleo Gërdhuqi:-** këto vërejtje i bëjmë vitin që vjen dhe i çojmë ankesat tenderit.

**Këshilltari Milto Nika:-** firma e pastrimit duhet të na përgjigjet,ata janë kopetent.

**Kryetari i këshillit:-** kontratat e plazheve publike ,shumë pak do të marrin nga Bashkia Himarë,kush ka aplikuar,a ka nga Bashkia Himarë,të jenë vendas sepse nuk kanë pse vijnë të huaj për aplikime,kush ka aplikuar?

**Drejtori Sokrat Kreku:-** ne kemi filluar procedurat dhe janë disa kritere për aplikimet,dhe në bazë të tyre procedojmë.

**Këshilltari Timoleo Gërdhuqi:-** kemi të drejt ne si këshill të shtojmë apo heqim parcela dhe deri çfarë afati? **Drejtori Sokrat Kreku:-** po,deri në muajin tetor.

**Këshilltarja Silva Burbo:-** 70% e plazheve jepen për shfrytëzim dhe 30% për publikun,si bëhet për plazhet e vogla ku ju e keni dhënë të shfrytëzohet 100%,ka kallëzime dhe deklarime se janë shfrytëzuar plazhet e vogla.

**Drejtori Sokrat Kreku:-** nuk është e vërtet.

**Këshilltarja Silva Burbo:-** Z. Kryetar kemi të drejt që t'na japin një informacion mbi plazhet ,kush është publik dhe kush privat,kur të dalin lejet kërkojmë informacion.

**Kryetari këshillit:** po,por në përgjithësi është punuar shumë mirë,ndërhyrje të vogla ka pasur.

**Kryetari i këshillit :** i jep leje kryetarit e fshatit Gjilekë.

Jam dakort me këshilltaren që sapo foli,në Gjilekë ka probleme me rastet e plazhit që janë privatizuar,nga 30% plazhet publike nuk janë as 5% ndaj I zbatoni planifikimit dhe merrni masa për parkingun publik.

**Këshilltarja Elisabeta Lamaj:-** kërkoj një kontroll për kopshtet,pasi mungojnë materialet bazë në njësinë Horë – Vranisht.

**Këshilltarja Thëllëza Kokaveshi:-** ne si këshill do të jemi në shqyrtim të të gjithave materiale që miratojmë dhe ju si strukturë bëni punën tuaj,çdo drejtor duhet të sjell informacion.

**Këshilltari Timoleo Gërdhuqi:-** nga drejtorja e shërbimeve kërkojmë të shpallin kush ka aplikuar për plazhet,të gjitha kontratat të jenë **transparente**.

**Këshilltari Qirjako Mërkuri:-**nuk ka kompetencë bashkia të ndërhyjë te ministria e turizmit që aplikimet të jenë të Bashkisë tonë.T'i drejtohem me shkresë Ministrisë.

**Këshilltari Milto Nika:-** ministria e turizmit është problem për turizmin,vetëm në zonën e Sarandës ka gati 9 mijë të ardhur,këto të ardhura janë për ne.Infrastruktura lë për të dëshiruar,mungojnë tabelat e orientimit ,stacionet urbane,duhet ta rrisim shërbimin e turizmit,kemi mangësia.

**Këshilltari Fuat Mati:-** në mbledhjen e fundit u diskutua për disa barriera për uljen e shpejtësisë në rrugët ku janë shkollat.

**Këshilltarja Silva Burbo** :- kërkojmë të ketë stacion autobusësh.

**Këshilltari Qirjako Mërkuri**:- kërkojmë zgjerimin e varrezave në Borsh.

**Kryetari këshillit** :- e hedhim në votim? Pro 14 këshilltar , 1 kundër ,0 abstenim.

**MIRATOHET VENDIMI NR.01, PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS,PLANIT TË SEZONIT TURISTIK PËR VITIN 2024.**

**Pika 3 e rendit të ditës.**

Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin nr,03 datë 29.01.2021 të këshillit të Bashkisë Himarë për disa ndryshime mbi rregulloren,për ngritjen ,funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në bashki.

**Miratohet vendimi nr.02 , për disa ndryshime në rregulloren për ngritjen,funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në Bashki me 15 vota pro,0 kundër, 0 abstenim.**

**Pika 4 e rendit të ditës.**

**Miratohet vendimi nr.03 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.33.datë 28.07.2023 të Këshillit të Bashkisë Himarë për miratimin e rregullores ,organizimin dhe funksionimin e këshillit.**

**Pika 5 e rendit të ditës.**

**Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar I bllok – ndihmës ekonomike si dhe nga fondet e buxhetit të Bashkisë Himarë.**

**Miratohet vendimi nr.04 mbi kriteret e dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar si dhe nga fondet e buxhetit të Bashkisë Himarë,me 15 vota pro, 0 kundër ,0 abstenim.**

**Pija 6 e rendit të ditës.**

**Miratohet vendimi nr.05 ,për dhënien e ndihmës ekonomike periudha 1 – 31 dhjetor nga fondi i kushtëzuar 6% I bllok – ndihmës ekonomike,2023.**

**Të ndryshme.**

Shqyrtimi i kërkesës për Z. Aleko Lati

Kryetari i këshillit lexon kërkesën,në të cilën shpreh se ka probleme me pronën të cilën ja kanë zaptuar dhe dal pronarë të tjerë ,sipas kërkesit pretendon se është pronar i tokës .

Këshilli Bashkiak do ti bëj kërkesë ASHK për certifikatë pronësie të tokës.

**Këshilltarja Mirka Gjiçali**:- bëhen disa punime në Pilur për panele diellore,dua të di kur ka kaluar me vendim të Këshillit ky vendim.

**Këshilltari Artionil Shirokaj**:- si fshat kërkojmë restaurimin e urës.

**Këshilltari Fuat Mati**:- kërkesa e Aleks Abszai për djegien e shtëpisë të diskutohet e t'i jepet zgjidhje ( nuk ka kërkesë me shkrim dhe dokumenta drejtuar këshillit në këtë mbledhje)

**Drejtori Sokrat Kreku**:- nuk më ka ardhur Shkresë zyrtare.

**Këshilltari Qirjako Mërkuri:-** kemi probleme me lagjen “ Shkallë” në Borsh ,kemi nevojë për përmirësimin e rrugës.

**Kryeplaku i fshatit Qazim Pali :-** kërkon rrugë në lagjen e tij.

Sqaron drejtori Sokrat Kreku dhe i jep të drejtë sepse rrugën e ka marr deti dhe thotë se do t'i jap zgjidhje brenda muajit.

**Këshilltarja Silva Burbo:-**sjell një shqetësim gojarisht se sipas sah këshilli bashkiak Sarandë ka miratuar një vendim mbi planin e menaxhimit për ekonominë kullosor në vendin e quajtur “ Hermec” për një afat 10 – vjeçar dhe pretendon se është në hartën pyjore të Bashkisë Himarë,kërkon një sqarim dhe verifikim nga drejtoria përkatëse.

**Mbledhjen e mbyll kryetari këshillit :- mirë u takoheshim në mbledhjen e radhës!**

**Sekretari**

Elena Memushaj

